



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr / prot.

Tiranë, më 14.7.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

ZNJ. D T.

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Adresa postare: Rruga “ ”, Shkalla Pallati , Kati Ap. A.

Të dhënat e kontaktit: e-mail:

Tel:

E nderuar znj. T

Në përgjigje të kërkesës juaj për informacion, datë 30.6.2022, e cila është protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. prot., datë 30.6.2022, ju informojmë se:

Nga fillimi i veprimtarisë së Komisionit dhe deri më 30 qershor 2022, janë shkarkuar nga detyra 204 subjekte rivlerësimi, nga të cilët **123** gjyqtarë, **77** prokurorë, **1** inspektor në ILD, **1** inspektor KLGJ dhe **2** ndihmës ligjorë. Pjesa më e madhe e vendimeve të shkarkimit nga detyra, janë kryesisht për komponentin e pasurisë, dhe pjesa tjetër e subjekteve të shkarkuar kanë edhe komponentin figurë ose edhe atë profesional.

Janë dorëhequr nga detyra, sipas nenit G të Aneksit kushtetues, **80** subjekte rivlerësimi, për të cilët është vendosur ndërprerje e procesit, nga të cilët **49** janë gjyqtarë, **21** prokurorë, **2** ish-Inspektorë në KLD dhe **7** ndihmësve ligjorë, si dhe **1** ish-prokuror.

Bashkëlidhur përgjigjes, lutem gjeni listën me emrat subjekteve të shkarkuar dhe të dorëhequr me vendim të KPK-së. Për t'u informuar me statistika të përditësuara, ju mund të aksesoni lirisht faqen tonë zyrtare, kategoria “Statistika” <https://kpk.al/statistika/> dhe kategoria “Vendime” <https://kpk.al/vendime/>.

Lidhur me pyetjen tuaj të datë 14.7.2022, në lidhje me kërkesën për informacion, ju sqarojmë se nuk mund t'ju vijmë në ndihmë me këtë informacion, pasi Komisioni i Pavarur i

Kualifikimit nuk është organ përgjegjës që administron dhe publikon formularët e dekriminalizimit sipas ligjit nr. 138/2015.

Duke ju uruar punë të mbarë, shpresojmë t'ju kemi ndihmuar me informacionin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

